

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



INFORMOHU
PËR NDIHMËN
JURIDIKE FALAS

**PYETJET QË SHTROHEN SHPESH NË
LIDHJE ME MARRËDHËNIET E PUNËS**

MË OFROHET QË TË LIDH KONTRATË PËR PUNËSIM. CILAT JANË TË DREJTAT E MIA?

Lidhja e një kontrate pune dhe raportin e punonjësve

Marrëdhënia e punës krijohet me marrëveshje ndërmjet jush si të punësuar dhe punëdhënësit. Rrjedhimisht, ju jeni njësoj të rëndësishëm në këtë marrëdhënie ashtu si edhe punëdhënësi. Keni të drejtë që merreni vesh për kushtet nën të cilat do hyni në marrëdhënien e punës, të merreni vesh për rrogën, për orarin e punës dhe për obligimet dhe detyrimet tuaja të punës. Keni të drejtë të mos lidhni kontratë (marrëveshje) dhe të mos filloni me punë nëse nuk ju përgjigjet ndonjë prej kushteve.

Sapo të nënshkruani kontratën, ju keni të drejtë të regjistroheni menjëherë në:

- ✓ Agjensi Punesimi,
- ✓ Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor dhe
- ✓ Fondi i Sigurimeve Shëndetësore.

Ju keni të drejtë të keni një kopje të kontratës së punës, të nënshkruar nga punëdhënësi.

Para fillimit të punës

- ✓ Ju keni të drejtë të mos filloni punë derisa të jeni i sigurt se jeni regjistruar dhe keni një praktikë.
- ✓ Para se të filloni të punoni, ju keni të drejtë të njiheni me mjedisin e punës, rregullat që ata kanë dhe vendin ku do të kryeni detyrat e punës. Megjithëse keni arsimin e duhur, dhe edhe nëse keni përvojë të mëparshme, ky është një mjedis i ri pune, dhe ju keni të drejtë të merrni trajnim gjatë punës.

Të drejtat e punësimit:

Keni të drejtë në pushim ditor prej 30 minutash, pushim ndërmjet 2 ditëve të 12 orëve të pandërprera, dhe pushim javor prej të paktën 24 orëve të pandërprera duke shtuar edhe 12 orë të pushimit ditor. Pushimi vjetor është të paktën 20 ditë pune, kurse me marrëveshjen apo me marrëveshjen kolektive mund të jetë edhe deri në 26 ditë pune në vjet.



Ke te drejte

- ✓ Keni të drejtë në rrogë dhe detyra të mjaftueshme të punës që të siguron rrogën. Rroga duhet të paguhet më së voni deri në ditën e 15-të të muajit për muajin paraprak.
- ✓ Keni të drejtë të trajtoheni me dinjitet, në mënyrë të barabartë me të tjerët dhe të jeni të mbrojtur nga çfarëdo shqetësimi nga të punësuarit, klientët apo eprorët.
- ✓ Keni të drejtë përfshiheni dhe të tregoni mendimin tuaj në të gjithë procedurat të cilat u referohen jush-ndëshkim, vërejtje, apo ndërprerje të marrëdhënies të punës.
- ✓ Keni të drejtë që të ndërprisni marrëdhënien e punës me afat të largimit që nuk është më i shkurtër se 30 ditë (kurse në kontratë mund të jeni marrë vesh edhe për afat të largimit me të gjatë), me njoftim me shkrim të punëdhënësit.
- ✓ Keni të drejtë që të parashtroni padi për kompensim të rrogave të papaguara, kontributeve, bonuseve për të cilat jeni marrë vesh dhe borxhet tjera në para. Këtë të drejtë e keni edhe pa e pushuar marrëdhënia e punës.
- ✓ Keni të drejtë që të jeni të mbrojtur nga ndëshkimi apo largimi nga puna për shkak të kërkesës për realizimin e cilësdo nga të drejtat e theksuara më sipër.

PËR ÇFARË DUHET TË KEM MË SHUMË KUJDES GJATË LIDHJES TË KONTRATË PËR PUNËSIM?

- ✓ Kontrolloni nëse në kontratë shkruan Kontratë (marrëveshje) për punësim, apo Kontratë në vepër, Kontratë për angazhim të punëtorit apo Kontratë për kryerje të shërbimit. Vetëm Kontrata për punësim është në fakt kontratë e cila u siguron të drejta dhe detyrime në pajtim me Ligjin për marrëdhënie të punës (siguri, pushime, rrogë).
- ✓ **Data e fillimit:** Data e fillimit me punë duhet të jetë të paktën një ditë pas datës të lidhjes të kontratës, që të mundet punëdhënësi t'ju paraqes si të punësuar në institucion.
- ✓ **Vendi i punës dhe detyrat e punës:** Siguroheni se e dini se cili është vendi i juaj i punës dhe se detyrat e punës janë përshkruar saktë dhe qartë. Kjo është shumë e rëndësishme që të mund të kryeni punën me sukses dhe në pajtim me kërkesat e punëdhënësit.
- ✓ **Sa zgjat kontrata:** A është kontrata në kohë të paktuar apo të caktuar?
- ✓ **Si do të zhvillohet puna:** A jeni me orar të plotë apo të shkurtuar të punës? A punoni në të njëjtin vend apo në më shumë vende të ndryshme? A punohet nga e hëna në të premte, apo punohet edhe në fundjavë? A punohet në ndrrime?
- ✓ **Rroga:** A është rroga sipas marrëveshjes? Kontrolloni nëse në kontratë vlera e rrogës është vendosur në vlerë bruto apo neto, që të siguroheni se është vlera e saktë.
- ✓ **Përgjigje:** A është rregulluar e drejta në pushim javor dhe vjetor? A keni të paktën 20 ditë pushim vjetor?
- ✓ **Pushimi i marrëdhënies të punës:** A është përcaktuar afati i largimit dhe sa ditë zgjat? A ekziston dispozita se nëse e ndërprisni marrëdhënien e punës duhet të paguani kompensim? Nëse ka dipozitë të tillë, e njëjta është në kundërshtim me ligjin dhe nuk mund të qëndrojë në Kontratën për punësim.

A MUND TË MA NDRYSHOJË PUNËDHËNËSI KONTRATËN PA PËQIMIN TIM?

Jo. Kontrata duhet të nënshkruhet nga të dy palët, edhe nga punëtori edhe nga punëdhënësi, dhe asnjë ndryshim, madje as ndryshimi më i vogël nuk mund të bëhet pa pëlqim me shkrim nga të dy palët.

CILAT JANË PASOJAT NGA LIDHJA E MARRËVESHJES(UJDISË) PËR PUSHIM TË MARRËDHËNIES TË PUNËS?

Marrëveshja për pushim të marrëdhënies të punës është dokument me të cilin punëtori dhe punëdhënësi pajtohen që marrëdhënia e punës e punëtorit të pushojë në datën e caktuar para skadimit të Kontratës për punësim.

Meqënëse marrëveshja për pushim e shpreh vullnetin e punëtorit që të pushojë marrëdhënien e punës, punëtorit nuk i takon kompensim në para në rast të papunësisë.



A MË TAKON KOMPENSIM PËR PUNËN E NATËS?

Nëse punoni ndrrim të natës (prej 22:00-06:00), punëdhënësi është i detyruar që t'ju sigurojë: pushim më të gjatë, ushqim përkatës apo kompensim të shpenzimeve për ushqim në lartësi prej 20% nga rrogë mesatare

neto për punëtor e paguar në Republikën e Maqedonisë në vitin paraprak, proporcionalisht për ditët kur punëtori punon natën, udhëheqje profesionale të procesit të punës dhe kontrolla të rregullta mjekësore.

A MË TAKON PUSHIMI VJETOR?

Po, secilit person të punësuar i takon pushim vjetor, pavarësisht nëse bëhet fjalë për orar të plotë të punës (8 orë në ditë) apo orar të shkurtuar të punës (4 orë në ditë), pavarësisht nëse kontrata është në orar të caktuar apo të pacaktuar.

Çdo person i punësuar ka të drejtë në të paktën 20 ditë pune pushim gjatë një viti. Me kontratën për punësim apo me marrëveshje kolektive, mund të përcaktohet që të punësuarit i takojnë më shumë ditë, por më së shumti deri në 26 ditë punë gjatë një viti.

Pushimin vjetor punëtori e shfrytëzon në marrëveshje me punëdhënësin, por gjatë kësaj duhet të keni kujdes për këtë:

- ✓ Punëtori duhet të shfrytëzojë dy ditë pune të pandërprera të pushimit vjetor deri në fund të vitit rrjedhës (31.12).
- ✓ Punëtori duhet të shfrytëzojë ditët tjera deri në 30.06 të vitit të ardhshëm.

E drejta në të gjithë pushimin vjetor fitohet pasiqë të punoni 6 muaj pandërprerë te punëdhënësi. Deri në atë moment, keni të drejtë në pjesë proporcionale të pushimit – dy ditë pune për secilin muaj të cilin e keni kaluar në punë.

Pyetje që shtrohen shpesh në lidhje me marrëdhëniet e punës

A MUNDEM QË KRAHAS PUSHIMIT VJETOR TË SHFRYTËZOJË EDHE DITË TJERA TË MUNGESËS TË PAGUAR NGA PUNA?

Po, krahas pushimit vjetor ju keni të drejtë edhe në shtatë ditë pune, të cilat mund t'i shfrytëzoni për lidhjen e martesës, lindjes të fëmijës (vetëm babai) dhe/apo vdekjes të kushëririt të afërt.

Gjithashtu, nëse jeni në shkollim apo shkollim shtesë, keni të drejtë në mungesë nga puna për shkak të dhënies

të provimit në ditën që është provimi. Me kontratën për punësim, me kontratatë tjetër ndërmjet jush dhe punëdhënësit apo me marrëveshje kolektive, mund të merreni vesh edhe për mungesë të paguar në më shumë ditë.

A MUND TË SHFRYTËZOJË MUNGESË PA PAGESË NGA PUNA?

Po, keni të drejtë të tillë të cilën mund ta shfrytëzoni më së shumti deri në tre muaj gjatë vitit kalendarik. Për kushtet e sakta nën të cilat mund të shfrytëzoni këtë të drejtë, ju lutemi shihni marrëveshjet kolektive të cilat vlejnë për sektorin tuaj.

E rëndësishme: Ju lutemi që të keni parasysh se mungesa pa pagesë nënkupton se në periudhën derisa e shfrytëzoni këtë të drejtë, ju jeni të çlajmëruar nga puna, nuk ju rrjedh stazhi, sigurimi shëndetësorë, pensional dhe invalidor. Punëdhënësi do ju punësojë sërish, dhe stazhi do të vazhdojë që t'ju rrjedhë nga momenti kur do të ndërprisni që të shfrytëzoni këtë të drejtë.





U LËDOVA NË PUNË. CILAT JANË TË DREJTAT E MIA?

Punëdhënësi është i detyruar që menjëherë, e më së voni në afat prej 48 orësh nga ngjarja, të parashtrijë Njoftim për fatkeqësi në punë deri te Inspektorati shtetëror i punës. **Kjo për ju është vërtetim se ngjarja me të vërtetë ka ndodhur në punë, në orarin e punës dhe gjatë kryerjes të marrëdhënieve të punës.**

Nëse jeni të siguar, mund të kërkonti kompensim të dëmit nga sigurimi nën kushtet e polisës tuaj të sigurimit.

Pyetje që shtrohen shpesh në lidhje me marrëdhëniet e punës

Mund të parashtroni kërkesa për kompensim të dëmit nga punëdhënësi, por vetëm nëse janë përmbushur këto 2 kushte:

- ✓ Punëdhënësi të mos ketë ndërmarrë masat përkatëse për mbrojtje në vendin e punës;
- ✓ Ju të keni mbajtur pajisjen mbrojtëse dhe lëndimi të mos jetë shkaktuar nga pakujdesia.

Nëse nga lëndimi ka ardhur deri te kufizimi i aftësisë tuaj për kryerjen e asaj punë, punëdhënësi mund t'ju caktojë në vend tjetër të punës të cilin mund ta kryeni, apo të kërkojë rikualifikim.

Nëse për shkak të lëndimit nuk jeni më në gjendje të punoni, keni të drejtë të parashtroni kërkesë për pension invalidor, në pajtim me kushtet e theksuara në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor.

A MË TAKON MBROJTJE E CAKTUAR GJATË SHTATËZANISË, LINDJES DHE PRINDËRIMIT?

Ndalohen të gjithë format e diskriminimit të punëtores për shkak të shtatëzanisë, lindjes dhe prindërimit. Vendi i juaj i punës është i sigurtë dhe ju nuk mund t'ju pushojë nga puna për shkak të shtatëzanisë, lindjes apo prindërimit. Punëtorët për shkak të shtatëzanisë dhe prindërimit kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë në marrëdhënien e punës.

Punëdhënësi është i detyruar që punëtorëve t'u mundësojë harmonizim më të lehtë të detyrimeve familjare dhe profesionale.

Të drejtat gjatë shtatëzanisë

- ✓ Pas shpalljes se jeni shtatëzënë, punëdhënësi është i detyruar të ndër marrë masa për siguri dhe shëndet në vendin tuaj të punës, që të bindet se të njëjtat nuk janë të dëmshme për shëndetin tuaj dhe shëndetin e frytit.
- ✓ Punëdhënësi nuk mund të kërkojë çfarëdo të dhënash për shtatëzanië e punëtores, përveç nëse ajo vet nuk i parashtron për shkak të realizimit të të drejtave gjatë kohës të shtatëzanisë.



- ✓ Gjatë kohës të shtatëzanisë edhe një vit pas lindjes, punëtorja nuk mund të bëjë punë nëse ajo punë rrezikon më shumë shëndetin e saj apo shëndetin e fëmijës, nuk mund të kryejë punë jashtë orarit të punës, apo të punojë natën.



Pushim me pagesë nga puna (e ashtuquajtura pushim i lehonisë)

Keni të drejtë në mungesë të paguar nga puna në kohëzgjatje prej nëntë muajsh pandërprerë, kurse për binjakët apo më shumë fëmijë të lindur menjëherë – 15 muaj. Nëse dëshironi, mund të ktheheni në punë edhe para përfundimit të mungesës, por jo para 45 ditësh nga dita e lindjes të fëmijës. Nëse ktheheni, krahas të drejtës në rrogë, keni të drejtë edhe në kompensim të rrogës për mungesë për shkak të shtatzanisë dhe prindërimit, në lartësi prej 50% nga vlera e caktuar të kompensimit për mungesë.

Pyetje që shtrohen shpesh në lidhje me marrëdhëniet e punës

Në fund të mungesës të prindërimit, keni të drejtë që të ktheheni në vendin e njëjtë të punës apo në vendin përkatës të punës sipas kushteve të kontratës të punës.

Pas përfundimit të mungesës në punë

- ✓ Pas përfundimit të mungesës nga puna për shkak të shtatzanisë, lindjes dhe prindërimit, keni të drejtë në mungesë prindërore pa pagesë deri në tre muaj në periudhën deri në mbushjen e moshës trevjeçare të fëmijës, në më së shumti tre pjesë, për shkak të kujdesit për fëmijën.
- ✓ Pasiqë të filloni të punoni me orar të plotë të punës, e derisa fëmija nuk ka mbushur një vjet, keni të drejtë në pushim të paguar gjatë orarit të punës, në kohëzgjatje prej një orë e gjysëm në ditë, në të cilën kohë llogaritet edhe pushimi ditor.

KU MUND TË DREJTOHEM PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS?

- ✓ Shoqata dhe klinika juridike të cilat janë të autorizuarra për dhënien e ndihmës juridike falas
- ✓ Avokatë me kompetenca të fituara për dhënien e ndihmës juridike dytësore
- ✓ Në zyrat rajonale të Ministria e Drejtësisë (lista e kontakteve në shtojcë):

Njësitë rajonale	Telefonat
Berovë	071 205 324
Manastir	071 223 392
Makedonski Brod	071 223 075; 078 640 786
Vinicë	071 213 964
Vallandovë	071 213 925
Gjevgjeli	071 224 678; 071 216 267
Gostivar	071 223 180
Dibër	071 223 768
Delçevë	071 283 948
Demir Hisa	075 766 695
Kavadarë	075 659 855
Kërçovë	071 224 652
Koçanë	071 221 580
Kratovë	
Kriva Pallankë	071 224 580
Krushevë	071 227 808
Kumanovë	071 227 962

Njësitë rajonale	Telefonat
Negotinë	071 223 191
Ohër	071 221 908
Prilep	076 232 886
Probishtip	078 330 434
Radovish	070 261 310
Resnjë	071 221 246
Sveti Nikole	071 227 862
Strugë	071 223 015
Strumicë	071 224 526
Tetovë	071 227 893
Veles	
Shtip	071 221 484; 070 821 089
Karposh	071221381
Qendra	078 442 006
Kisella Vodë	071 224 104
Gazi Babë	071 213 798
Çairit	





INFORMOHU
PËR NDIHMËN
JURIDIKE FALAS

www.pravnapomos.mk

Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.
Qëndrimet e shprehura në të nuk shprehin domosdoshmërisht mendimin zyrtar të secilës palë.

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



Republika e Maqedonisë së Veriut
Ministria e Drejtësisë